

PROÇEDURA PP. - 07.2

**Realizimi i shërbimit të çertifikimit
të Sistemit të Administrimit të Cilësisë në
organizmat Multisite.**

GJENDJA E DOKUMENTIT

REV.	PAR.	PAG.	PËRSHKRIM	Data REV.
01			Lëshimi i dokumentit	11.11.2010

KOPJE E KONTROLLUAR Nr.

KOPJE E PAKONTROLLUAR

I REDAKTUAR	SHIKUAR DHE MIRATUAR
Proçesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme nr.01/10 dt. 11.11.2010	Proçesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme nr.01/10 dt. 11.11.2010



TREGUES

1. Hyrje.
2. Kushtet .
3. Kërkesat e çertifikimit.
4. Kontrolli fillestar.
5. Çertifikim dhe përdorim i logotipit.
6. Kontrolli i mirëmbajtjes.
7. Zgjerim i organizmave që bëjnë pjesë tek multisitet
8. Kontrolli i rinovimit.

REFERIMET NORMATIVE

- ✓ UNI-EN-ISO-17021
- ✓ IAF MD1
- ✓ RT – ACCREDIA



1. Hyrje

Ky dokument përcakton objektivat dhe fazat kryesore të shërbimit të Kontrollit dhe të Çertifikimit të Sistemit të Administrimit të Cilësisë që I.C.D.Q. SH.P.K. u kryen klienteve të vet.

Kjo proçedurë është e plotë dhe nuk përjashton PP.-07.1.1 – Paraqitja e Shërbimit të Çertifikimit të Sistemeve të Administrimit – meqënëse përcaktohen formalitetet specifike të kontrollit pranë organizmave me shumë seli (MULTISITE).

2. Kushtet

Përcaktohen si Multisite një organizëm që zotëron një seli qendrore dhe një rrjet zyrash lokale ose filiale (njësi operative) ose kantiere (seli të përkohshme) që zhvillojnë veprimtari të ngjashme me ato që zhvillohen tek selia qendrore. Ky lloj organizmi nuk përbën domosdoshmërisht një entitet të vetëm juridik, por secila seli duhet të ketë një lidhje të llojit ligjor ose kontraktues me selinë qendrore të organizmit dhe duhet t'i nënshtrohet një sistemi cilësie të përbashkët, i cili është projektuar, zbatuar dhe i është nënshtruar një mbikqyrjeje të vazhdueshme nga ana e selisë qendrore, e cila është përgjegjëse.

Selia qendrore ka të drejtë të ndërmarrë veprime korigjuese dhe/ose parandaluese, kur janë të nevojshme, në secilën seli.

Më poshtë citohen shembujt vijues, thjesht për qëllim shembulli dhe jo tregues,:

- ✓ organizmat që operojnë në franchising;
- ✓ shoqëritë e shërbimeve ose të prodhimit me një ose më shumë njësi operative dhe/ose seli të përkohshme të cilat ofrojnë një shërbim analog;
- ✓ sipërmarrjet e prodhimit me një rrjet zyrash shitjeje të vendosura në terren.

Sistemi Multisite ekziston vetëm nëse plotësohen të gjithë kërkesat dhe përcaktimet e mëposhtme, mosrespektimi i vetëm njëres prej tyre, pengon administrimin e praktikës si "Multisite":

- ✓ produktet ose shërbimet e realizuara nga të gjitha selitë (njësitë operative ose selitë e përkohshme) duhet të jenë të llojeve të ngjashme dhe duhet të realizohen ose të prodhohen kryesisht duke ndjekur të njëjtat metoda dhe proçedura;
- ✓ sistemi i cilësisë i organizmit duhet të administrohet nga selia qendrore dhe duhet të jetë objekt i kontrolleve nga ana e selisë qendrore. Të gjithë selitë (njësi operative ose seli të përkohshme), përfshirë funksionet e administratës qendrore, janë objekt i programit të kontrollit të brendshëm dhe duhet të jenë kontrolluar përpara se të fillojë vlerësimi i organizmi të çertifikimit;
- ✓ duhet të demonstrohet që selia qendrore ka përcaktuar një sistem administrimi të cilësisë në përputhje me normën dhe që ai aplikohet nga organizmi përfshirë edhe të gjithë legjislaturën e aplikueshme;
- ✓ organizmi duhet të demonstrojë aftësinë e tij të grumbullimit, analizimit dhe administrimit për të gjithë selitë (njësi operative ose seli të përkohshme) të të



dhënavë që vijojnë më poshtë përveçse edhe aftësinë dhe autoritetin për të nisur, nëse janë të nevojshme, ndryshimet tek organizmi:

- * dokumentacionin e sistemit të administrimit dhe ndryshimet e tij;
- * rikontrollin e Drejtorisë;
- * ankesat;
- * vlerësimin e veprimeve korrigjuese;
- * planifikimin e kontrolleve të brendshme dhe analizën e rezultateve;
- * kërkesat juridike të ndryshme.

Devijimet e vazhdueshme në aplikimin e proçedurave të SAC Multisite nga ana e disa prej subjekteve (si përsëmbull nevojën e përdorimit të vazhdueshëm të planeve të ndryshme të cilësisë, kontraktuese ose rregullues të ndryshëm, etj.) nuk lejojnë administrimin dhe mirëmbajtjen e certifikimit multisite.

Njësi operative përcaktohet: Çdo seli e ndryshme nga selia zyrtare në të cilën organizmi zbaton veprimtarinë e vet ose një pjesë të saj dhe gjithsesi duhet të njihet tek dëshmia e dhomës së tregtisë si "Njësi Lokale", ose në prani të një kontrate të rregullt qeraje.

Seli e përkohshme përcaktohet: Çdo seli e ndryshme nga selia zyrtare dhe e ndryshme nga njësi operative (nuk është i regjistruar tek dëshmia e dhomës së tregtisë së organizmit) në të cilën organizmi zhvillon me kohë të përcaktuar (ditë, muaj ose vite të përcaktuara nga kontrata) proçese të rëndësishme të veprimtarisë së vet ose një pjesë të saj (nuk duhet të konsiderohen si seli të përkohshme selitë e klientit ku kryhen faza terminale të proçesit kryesor i cili është verifikuar pranë selisë zyrtare, njësisë operative ose selisë së përkohshme).

3. Kërkesa e certifikimit

Çfarëdo organizmi që është i interesuar për shërbimet e certifikimit të I.C.D.Q. SH.P.K. duhet të administrojë kërkesën e certifikimit siç është përcaktuar tek PP.-07.1.1.

Bashkë me kërkesën e ofertës KO.PP.03.1 klienti duhet të përmbushë edhe Shtesën KO.PP.03.1 Multisite – i posaçëm për organizmat multisite.

Kontrata do të nënshkruhet direkt nga I.C.D.Q. SH.P.K. dhe nga selia qendrore që kërkon certifikimin Multisite.

4. Kontrolli fillestar

I.C.D.Q. SH.P.K. planifikon Kontrollin fillestar ashtu siç është përcaktuar te P.P.-07.1.1.

Kontrolli i Fazës I

Kontrolli i Fazës I realizohet pranë selisë zyrtare ose operative të subjektit që kërkon certifikimin, e cila merr funksionin qendror brenda sistemit Multisite (kryesues).

Në fazën I duhet të marrin pjesë të gjithë përfaqesuesit e organizmave që bëjnë pjesë tek Multisite që kërkojnë certifikimin. Në këtë fazë kontrollohen të gjitha kërkesat e vetë Multisitetit të përcaktuara tek pika e mëparshme (kriteret e pranimit –



vetë SAC – etj.). Nëse gjatë fazës I haset mos aplikimi i sistemit multisite, do të proçedohet siç është përcaktuar tek P.P.- 07.1.1 – par 6.

Në përfundim të Fazës I do të lëshohet vetëm një raport subjektit kryesues.

Kontrolli i Fazës II

Kontrolli i Fazës II realizohet pranë organizmave që bëjnë pjesë tek multisiti, sipas një sistemi me përzgjedhje i përcaktuar nga udhëzuesi operativ i afateve të kontrollit të multisitit. Elementi i përzgjedhur do të përlogaritet duke marrë në konsideratë të gjithë organizmat që do të bëjnë pjesë tek Multisiti duke konsideruar si njësitë operative ashtu edhe selitë e përkohshme.

Për secilin organizëm të kontrolluar, grupi i Kontrollit lëshon një raport të posaçëm i cili përmban numrin dhe përshkrimin e problematikave, si dhe qëllimin e çertifikimit të propozuar në funksion të evidencave të mbledhura gjatë zhvillimit të kontrollit.

Mbledhja përfundimtare kryhet pranë organizmit kryesues tek sistemi Multisite. Grupi i kontrollit do t'i komunikojë dhe dokumentojë përmes një raporti përfundimtar, organizmit kryesues të gjitha problematikave e klasifikuara sipas kategorive që lidhen me tërë sistemin multisite.

Organizmi kryesues merr masa për të menaxhuar këto problematika për të gjithë sistemin Multisite.

5. Certifikimi dhe përdorimi i logotipit

Pasi të jetë përmbushur pozitivisht Kontrolli Fillestar, I.C.D.Q. SH.P.K. lëshon një çertifikatë të vetme me Emërtimin Juridik të Organizmit dhe adresën e selisë zyrtare të organizmit kryesues, së bashku me listën e organizmave që bëjnë pjesë tek multisiti.

Për secilin organizëm që bën pjesë tek sistemi multisite lëshohet një "nën – çertifikatë" e cila përmban të dhënat specifike të organizmit më vete (emri i subjektit, adresa e njësisë operative, qëllimi specifik dhe kodi relativ EA), si dhe referimet tek Sistemi Multisite të cilit i përket.

Të gjithë çertifikatat që i përkasin multisitit, kanë të njëjtën datë lëshimi dhe skadence.

Organizmi kryesues është i detyruar t'i komunikojë menjëherë I.C.D.Q. SH.P.K. të gjitha ndryshimet e mundshme të ndodhura tek sistemi multisite dhe tek organizmat pjestare, të njësive operative dhe selive të përkohshme.

Nëse nuk kryhet ky komunikim, do të konsiderohet si një përdorim jo i duhur i çertifikatës, duke sjellë aplikimin e masave të duhura si tek proçedura P.P.-07.1.1– par 14.

Gjatë zhvillimit të kontrollit të mbikqyrjes dhe/ose zgjerimit, pasi të jetë kërkuar nga organizmi kryesues, është e mundur të proçedohet si me zgjerimin e Multisitit ashtu edhe me fushën e aplikimit të çertifikimit.

Në rastin kur ekzistojnë seli të përkohshme këto nuk do të përfshihen në çertifikim, por do të kenë si qëllim të vetëm, që të përdoren për konfirmimin e veprimtarive të zhvilluara nga organizmi.

Për përdorimin e logotipit të I.C.D.Q. SH.P.K. shihen dokumentat P.P.-07.1.1. dhe 2.6.8.



6. Kontrolli i Mirëmbajtjes

Pasi të jetë përcaktuar përmasa e organizmit të përzgjedhur, I.C.D.Q. SH.P.K. i komunikon organizmit kryesues, emrat e Organizmave pjestare të Multisitit të cilat do t'i nënshtrohen kontrollit së bashku me njësitë e tyre operative dhe me selitë e përkohshme tek të cilat do të kryhet kontrolli periodik, duke bërë të qartë që organizmi kryesues do t'i nënshtrohet gjithmonë kontrollit.

Në rastin kur hasen probleme që rrezikojnë mirëmbajtjen e çertifikimit edhe vetëm pranë njëres prej njësive operative të çertifikuara, i gjithë sistemi multisite mund të pezullohet / tërhiqet sipas dispozitave të parashikuara nga proçedura P.P.-07.1.1. - par 14.

7. Zgjerimi i organizmave që bëjnë pjesë tek multisiti

Në rastin kur kërkohet futja e organizmave ose njësive të reja tek sistemi multisite, org. kryesues duhet të dërgojë një kërkesë të posaçme pranë I.C.D.Q. SH.P.K. duke treguar të gjitha të dhënat e parashikuara tek dok. RO.P.P.03.1 – Multisite.

I.C.D.Q. SH.P.K. proçedon me analizimin e të dhënave të dërguara për të verifikuar respektimin e kërkesave multisite ashtu siç parashikohen tek proçedura në fjalë.

Futja e çdo grupi të ri njësisish operative tek Multisiti, konsiderohet si një tërësi e pavarur për përcaktimin e org. të përzgjedhur i cili do t'i nënshtrohet kontrollit fillestar të çertifikimit (faza I + faza II).

Futja e çdo grupi të ri njësisish operative tek Multisiti, i bashkangjitet grupit ekzistues për llogaritjen e org. të përzgjedhur për sa i përket kohëzgjatjes së kontrolleve të mirëmbajtjes dhe rinovimit.

Çdo shtesë tek multisiti përbën përditsimin e planit trevjeçar nga ana e OtëÇ duke mundësuar shtimin si të kohës së kontrolleve ashtu edhe të numrit të selive që do të kontrollohen, siç parashikohet nga Udhëzuesi Operativ i posaçëm.

8. Kontrolli i rinovimit

Duke ruajtur përlllogaritjen e afateve të kontrollit, ashtu si tek udhëzuesi operativ i posaçëm, kontrolli i rinovimit parashikon domosdoshmërisht kontrollin e organizmave që deri në atë moment nuk i janë nënshtuar asnjë kontrolli në seli.